



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 970/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për shkak të parregullsive për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Gjakovë.

Arsyetim

PZAP-i , më datën 01.12.2013, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AKR me të cilën pretendohet se me datën 01.12.2013 në fshatin Cernjan të komunës së Gjakovës ka ndodhur publikimi i videove të procedurës së votimit nga aktivist të AAK-së në linkun: <https://www.facebook.com/photo.php?v=6693870830928228&set=fb.100000640906478&type=28&theater>, e që sipas parashtruesit të ankesës bie në kundërshtim me ligjin dhe kodin e mirësjelljes.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana subjektit politik AKR, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesa, janë të pabazuara, dhe të pa argumentuara, andaj një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i përgjithshëm dhe i pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse nga shkak se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë

provë shtese ankesës së parashtruar, me të cilat do të mund të administrohej lënda, ose do të mund të verifikohej vërtetësia e shkeljes së pretenduar. Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar shkeljet që janë cekur në ankesë, PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 970/2013 më datën 02.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.